



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Kryesia e Kuvendit
P-082

Prishtinë, më 6 shkurt 2017, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C -301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 6 SHKURT 2017

Në mbledhje morën pjesë: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit; Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Aida Dërguti dhe Fikrim Damka, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Zenun Pajaziti, Ismet Beqiri, Driton Çaushti, Pal Lekaj, Valdete Bajrami dhe Myfera Shinik.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Avni Bytyçi dhe Valmir Klaiqi.

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Musli Krasniqi.

Nga OSBE-ja: Sanije Berisha,

Nga EUSR-ja: Blerta Bejtullahu dhe

Nga NDI-ja: Shefki Kastrati.

Mbledhjen e drejtoi Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mëparshme,
2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave dhe
4. Të ndryshme.

* * *

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit, e mbajtur më 16 janar 2017

Kryesia e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit, të mbajtur më 16 janar 2017.

2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës

Kryesia, pasi i shqyrtoi përgatitjet për seancë plenare, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që seanca plenare e Kuvendit të mbahet të enjten, më 9 shkurt 2017, me fillim në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

1. *Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,*
2. *Koha për pyetje parlamentare,*
3. *Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme,*
4. *Votimi i Propozim-rezolutës në lidhje me organizimin e arsimit parashkollor, parafillor dhe parauniversitar në Kosovë,*
5. *Votimi i Propozim-rezolutës në lidhje me arrestimet e aktivistëve të Lëvizjes “Vetëvendosje”,*
6. *Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e një (1) anëtari të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës,*
7. *Interpelanca e kryeministrit të Kosovës, Isa Mustafa, sipas kërkesës së deputetit Rexhep Selimi, i mbështetur edhe nga 14 deputetë nënshkrues, në lidhje me situatën e krijuar në Mitrovicë,*
8. *Interpelanca e kryeministrit të Kosovës, Isa Mustafa, sipas kërkesës së deputetit Visar Ymeri, i mbështetur edhe nga 8 deputetë nënshkrues, në lidhje me përgjegjësinë mbi Ligjin e sigurimeve shëndetësore në Republikën e Kosovës,*
9. *Debat parlamentar në lidhje me Forcat e Sigurisë së Kosovës, sipas kërkesës së deputetit Daut Haradinaj, i mbështetur edhe nga 10 deputetë të tjerë nënshkrues,*

10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 05/L-129 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-149 për ekzekutimin e sanksioneve penale,
11. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 05/L-127 për plotësimin e Ligjit nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit,
12. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 05/L-150 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës,
13. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 05/L-135 për ndërmjetësim,
14. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 05/L-133 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-036 për statistikën zyrtare të Republikës së Kosovës,
15. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 05/L-143 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-072 për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin 04/L-214,
16. Shqyrtimi i Agjendës për Reforma Evropiane (ARE),
17. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të nenit 11 të Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës,
18. Zgjedhja e 1 (një) anëtari të Këshillit Gjyqësor të Kosovës nga radha e komuniteteve tjera,
19. Zgjedhja e 1 (një) anëtari të Bordit për Ankesa të Medieve,
20. Votimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për lirinë fetare në Kosovë
21. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-137 për ratifikimin e Marrëveshjes përkitazi me themelimin e Fondit të Ballkanit Perëndimor,
22. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-149 për ratifikimin e Marrëveshjes për themelimin e Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor ndërmjet Kosovës, Shqipërisë, Bosnjë-Hercegovinës, Malit të Zi, Maqedonisë dhe Serbisë,
23. Zgjedhja e 1 (një) anëtari të Këshillit Gjyqësor të Kosovës nga radha e komunitetit serb.

* * *

3. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave:

1. Procedimi i Projektligjit për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave nga pjesët veriore të Kosovës, hartuar nga deputetja Safete Hadërgjonaj, e mbështetur edhe nga 25 deputetë tjerë nënshkrues

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me procedimin e Projektligjit të lartshënuar, nxori këtë:

PËRFUNDIM

1. Projektligji për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave nga pjesët veriore të Kosovës, i hartuar nga deputetja Safete Hadërgjonaj, e mbështetur edhe nga 25 deputetë, t'iu shpërndahet deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

2. Ngarkohet Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, si komision funksional, që ta shqyrtojë Projektligjin në parim dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin me rekomandime, para shqyrtimit të parë në seancë plenare.

2. Kërkesa e deputetes Teuta Haxhiu, e mbështetur edhe nga 9 deputet tjerë nënshkrues, për debat parlamentar me temë: "Respektimi i të Drejtave të Njeriut"

Kërkesa e lartshënuar u shty për mbledhjen e radhës të Kryesisë së Kuvendit.

3. Kërkesa e deputetit Daut Haradinaj, i mbështetur edhe nga 10 deputetë tjerë nënshkrues, për debat parlamentar në lidhje me Forcat e Sigurisë së Kosovës

Kërkesa e lartshënuar u radhit në rend të ditës të seancës plenare, më 9 shkurt 2017.

4. Kërkesa e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike për auditimin e raporteve financiare dhe raporteve të deklarimit financiar të fushatës së subjekteve politike për vitet 2013, 2014, 2015 dhe 2016

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

VENDIM

1. Ngarkohet Administrata e Kuvendit, përkatësisht Drejtoria e Prokurimit që konform Ligjit për financimin e subjekteve politike t'i ndërmarrë veprimet e nevojshme dhe të bëjë thirrje të hapur për aplikim për përzgjedhjen e së paku 10 auditorëve të licencuar për shpalljen e ofertës për auditimin e raporteve vjetore financiare dhe raportet e deklarimit financiar të fushatës së subjekteve politike për vitet 2013, 2014, 2015 dhe 2016.

2. Mjetet buxhetore për përmbushjen e këtij obligimi të paraparë në pikën 1 (një) të këtij vendimi mbulohen nga Buxheti i Kuvendit të Kosovës.

5. Kërkesa për mbulimin e shpenzimeve lidhur me Konferencën e Parlamentit Evropian që do të mbahet më 3 mars 2017, në Prishtinë

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori edhe këtë:

VENDIM

Kuvendi i Kosovë i mbulon shpenzimet për mbajtjen e Konferencës Ndërparlamentare, e cila do të mbahet në Prishtinë, nga 2 - 4 mars 2017, sipas kërkesës së bashkangjitur me nr. 05/3101/DO-1578, datë 1 shkurt 2017.

6. Kërkesa e Këshillit Koordinues të Asociacioneve Familjare të të Zhdukurve të Kosovës për mbështetje financiare

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

VENDIM

1. Këshilli Koordinues i Asociacioneve Familjare të të Zhdukurve të Kosovës mbështetet financiarisht në shumën e mjeteve prej 2 350 (dymijë e treqind e pesëdhjetë) euro për realizimin e aktiviteteve të këtij këshilli.

2. Organizimin dhe aktivitetet për shënimin e Javës së të Pagjeturve në Kosovë për vitin 2017, si dhe shpenzimet lidhur me këtë aktivitet në Kosovë i merr përsipër Kuvendi i Kosovës.

7. Njoftimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me transferimin e mjeteve buxhetore për Radiotelevizionin e Kosovës për periudhën 1 janar - 31 mars 2017

Kryesia u njoftua lidhur me transferimin e mjeteve buxhetore për Radiotelevizionin e Kosovës për periudhën 1 janar - 31 mars 2017, në shumë prej 2 750 000 (dy milionë e shtatëqind e pesëdhjetë mijë) euro.

4. Të ndryshme

1. Kërkesa e Komisionit për Punë të Jashtme për lejimin e udhëtimit zyrtar në Shqipëri

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

VENDIM

1. Anëtarëve të Komisionit për Punë të Jashtme: Elmi Reçica, Teuta Rugova, Qerim Bajrami, Blerta Deliu-Kodra, Luljeta Veselaj-Gutaj, Ismet Beqri, Puhie Demaku, Pal Lekaj dhe Zafir Berisha u lejohet udhëtimi zyrtar në Shqipëri, prej 9 - 10 shkurt 2017.

2. Shpenzimet e udhëtimit, akomodimit (me tejkalim të mundshëm të shpenzimeve), si dhe mëditjet për të lartshënuarit në pikën 1 (një) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

2. Kërkesa Komisionit për të Drejta të Njeriut, Persona të Pagjetur dhe Peticione për lejimin e udhëtimit zyrtar në Shqipëri

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

VENDIM

1. Anëtarëve të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Persona të Pagjetur dhe Peticione: Lirije Kajtazi, Salihe Mustafa, Nenad Rashiq, Mexhide Mjaku-Topalli, Hetem Arifi,

Mytaher Haskuka, Teuta Haxhiu, Shukrije Bytyqi dhe Kujtim Paçaku u lejohet udhëtimi zyrtar në Shqipëri, prej 20 - 22 shkurt 2017.

2. Shpenzimet e akomodimit për 5 deputetë i mbulon Kuvendi i Shqipërisë, ndërsa shpenzimet e akomodimit për 4 deputetë tjerë pjesëmarrës, si dhe shpenzimet e udhëtimit dhe mëditjet për të lartshënuarit në pikën 1 (një) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

3. Kërkesa e Komisionit për Buxhet dhe Financa për lejimin e udhëtimit zyrtar në Shqipëri

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

VENDIM

1. Anëtarëve të Komisionit për Buxhet dhe Financa: Naser Osmani, Safete Hadërgjonaj, Shukri Buja, Labinotë Demi-Murtezi, Besa Gaxheri, Salih Morina, Shqipe Pantina, Bali Muharremaj, Enver Hoti dhe Fikrim Damka u lejohet udhëtimi zyrtar në Shqipëri, prej 23 - 26 shkurt 2017.

2. Shpenzimet e udhëtimit, akomodimit dhe rezervimit të sallës për mbajtjen e punëtorisë, si dhe mëditjet për të lartshënuarit në pikën 1 (një) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

4. Obligimet buxhetore nga kategoria ekonomike “subvencione dhe transfere” nga viti 2016 të bartura në vitin buxhetor 2017

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

VENDIM

1. Obligimet buxhetore të mbetura nga viti 2016, sipas vendimeve të Kryesisë së Kuvendit, kategoria ekonomike “subvencione dhe transfere”, dhe të bartura në vitin 2017, të paguhen nga buxheti i Kuvendit për vitin 2017, si në vijim:

1.1. Vendimi nr. 05-V-464, datë 19 dhjetor 2016, për participim me mjete financiare, në shumën 20 000 euro për realizimin e marrëveshjes me USAID-in,

1.2. Vendimi nr. 05-V-392, datë 19 shtator 2016, për mbështetje financiare, në shumën prej 7 000 euro, Shoqatës për Teknologji të Informacionit dhe Komunikimit të Kosovës (STIKK),

1.3. Vendimi nr. 05-V-393, datë 19 shtator 2016, për mbështetje financiare, në shumën prej 5 000 euro, Qendrës Inovative të Kosovës (ICK),

1.4. Vendimi nr. 05-V-447, datë 17 nëntor 2016, për mbulimin e shpenzimeve me rastin e shënimit të 25-vetorit të shpalljes së Kushtetutës së Kosovës, në shumën prej 4 960 euro,

1.5. Vendimi nr. 05-V-465, datë 19 dhjetor 2016, për mbështetje financiare, në shumën prej 2 583 euro, Shoqatës së të Verbërve të Kosovës,

1.6. Vendimi, nr. 05-V-466 datë 19 dhjetor 2016, për mbështetje financiare, në shumën prej 2 000 euro, Lidhjes së Invalidëve dhe Viktimave Civile të Luftës,

1.7. Vendimi nr. 05-V-460, datë 6 dhjetor 2016, për mbështetje financiare, në shumën prej 1 500 euro, Shoqatës së Malazezëve të Kosovës, dhe

1.8. Vendimi nr. 05-V-467, datë 19 dhjetor 2016, për mbështetje financiare, në shumën prej 700 euro, Organizatës për Fëmijë pa Kujdes Prindëror,

2. Ngarkohet Administrata e Kuvendit që ta zbatojë këtë vendim.

5. Kërkesa e kryetarit të Komisionit Parlamentar për Stabilizim-Asociimin, z. Xhavit Haliti, për staf mbështetës për komision

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

VENDIM

1. Miratohen 3 (tri) pozita të reja për mbështetjen e Komisionit Parlamentar për Stabilizim-Asociim BE-Kosovë.
2. Ngarkohet Administrata e Kuvendit që ta zbatojë këtë vendim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit.

6. Kërkesa për rialokim të brendshëm të buxhetit të Kuvendit për vitin 2017

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

VENDIM

1. Mbështetur në nenin 18.3 të Ligji për Buxhetin e Republikës së Kosovës nr. 05/L-25, ndarjet e Kuvendit, nën-programi Administrata e Kuvendit, bëhet rialokimi i mjeteve në kategorinë ekonomike “mallra dhe shërbime” si vijon:

- Nga nënkategoria 13310 shpenzimet për internet, shuma prej 600€ të rialokohet në nënkategorinë 14510 tatimi në qira,
- Nga nënkategoria 13410 shërbime të arsimimit dhe trajnimit shuma prej 600€ të rialokohet në nënkategorinë 14510 tatimi në qira,

- Nga nënkategoria 13410 shërbime të arsimimit dhe trajnimit shuma prej 4 400€ të rialokohet në nënkategorinë 14110 qiraja për ndërtesa,
- Nga nënkategoria 13720 naftë për ngrohje qendrore shuma prej 4 000€ të rialokohet në nënkategorinë 14110 qiraja për ndërtesa,
- Nga nënkategoria 13770 derivate për gjenerator shuma prej 2 400€ të rialokohet në nënkategorinë 14110 qiraja për ndërtesa,
- Nga nënkategoria 13610 furnizim për zyre shuma prej 10 400€ të rialokohet në nënkategorinë 13953 sigurimi i ndërtesave,
- Nga nënkategoria 13610 furnizim për zyre shuma prej 10 000€ të rialokohet në nënkategorinë 13503 kompjuter më pak se 1 000€.

2. Rialokimi i mjeteve kërkohet për mbulimin e shpenzimeve të qirasë për OJQ “Toka” në shumë prej 11 000€, si dhe tatimit në qira në shumë prej rreth 1 200€, të cilat nuk janë përfshirë në buxhetin e Kuvendit për vitin 2017, për sigurimin e ndërtesave në vitin 2016, sipas kontratës (Operatori Ekonomik nuk u është përmbajtur kushteve të kontratës) dhe për kompjuterë rritet sasia e blerjes së tyre.

7. Kërkesa e OJQ-së “Toka” për pagesën e qirasë, sipas Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Kuvendit, Fondacionit ERSTE dhe OJQ-së “Toka”

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

VENDIM

Në bazë të Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Kuvendit të Kosovës dhe Fondacionit ERSTE dhe OJQ-së “Toka”, nënshkruar më 6 korrik 2016, Kuvendi duhet të sigurojë hapësirën e nevojshme për OJQ-në “Toka”, deri në sigurimin e hapësirave tjera.

8. Kërkesa për mbulimin e shpenzimeve për të ftuarit më 17 Shkurt 2017

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

VENDIM

1. Miratohet kërkesa për mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe akomodimit për të gjithë të ftuarit më 17 Shkurt 2017, të cilët do të jenë pjesëmarrës në shënimin e përvjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Kosovës.

2. Mjetet e parapara në paragrafin 1 (një) të këtij vendimi ndahen nga kategoria ekonomike “mallra dhe shërbime” e buxhetit të Kuvendit të Kosovës.

9. Njoftimi me Projektin Kapital për Investime në Sallën Plenare (ndërrimi i pajisjeve)

Kryesia, pasi u njoftua me projektin e lartshënuar, mori këtë:

VENDIM

1. Kryesia e Kuvendit i caktoi 2 (dy) nënkryetarët e Kuvendit, z. Xhavit Haliti dhe znj. Aida Dërguti, për ta monitoruar zbatimin e Projektit Investime Kapitale në Sallën e seancave plenare të Kuvendit (ndërrimi i pajisjeve), vlera e të cilit është 550 mijë euro, që do të realizohet gjatë vitit 2017.

2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

Kryetari e mbylli mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit në orën 13:20 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Kadri VESELI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale